



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.31/2018

Prishtinë, më 4 tetor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Saranda Bogujevci dhe Shemsi Syla.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Adelina Hasani-KDI, Leutrim Hasani-KDI, Flora Kryeziu-UNICEF dhe Sanije Berisha-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për peticione;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për peticone

Kryetarja, tha se e kemi një projektligj të proceduar nga Lëvizja Vetëvendosje, por kemi edhe një dokument të punuar në legjislaturën e kaluar nga Komisioni Funkcional. Tani, ne duhet të

vendosim dhe duhet që këtë projektligj ta procedojmë për në Kuvend. Ajo hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Teuta Haxhiu, tha se në legjislaturën e kaluar, ky komision ka bërë një punë të madhe, duke hartuar një dokument, i cili është mirë të procedohet si projektligj i Komisionit Funkcional dhe tha se projektligjin e tanishëm nuk mund ta përkrahë, pikërisht pse komisioni ka bërë një punë shumë të madhe në hartimin e atij dokumenti, i cili është më i kompletuar se ky projektligj që e kemi sot në shqyrtim.

Ajo tha se ky projektligj të procedohet në Kuvend, por pa përkrahjen e komisionit dhe të fillohet me procedurat për një Projektligj për peticione, nga Komisioni Funkcional.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në legjislaturën e kaluar është investuar dhe punuar shumë që të kemi një dokument, në bazë të cilit i trajtojmë peticionet dhe është bërë një dokument më i gjerë se ky dokument që e kemi tani dhe çdoherë kam iniciuar që të procedohet ai dokument. Ky dokument që është tani, është i njëjtë me atë që e ka prezantuar në Komision Funkcional, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, ndërsa theksoi se ka dilema që propozuesi i këtij projektligji, a ka të drejtë të marrë atë dokument dhe ta paraqesin si dokument të tyre dhe me intereson të di, a e kanë marrë pëlqimin nga GPSJP? Për procedimin e këtij projektligji jemi në dilema dhe ne mund ta procedojmë në Kuvend për mosmiratim, por me arsyetimin se kemi punuar një dokument dhe se dokumenti i Komisionit Funkcional është më përmbajtësor dhe më i kompletuar.

Kryetarja, më pas, hodhi në votim Projektligjin për peticione.

Kryetarja konstatoi se me 7 vota abstenim, 1 kundër dhe 0 vota për, komisioni vendosi të nxjerrë këtë rekomandim:

Të mos miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-076 për peticione.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kryetarja, për këtë pikë të rendit të ditës, ia dha fjalën deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj, kryesuese e grupit punues për monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

Luljeta Veselaj Gutaj, në fillim të fjalës së saj, paraqiti aspekte të detajuara nga raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Grupi punues ka përfunduar punën në monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe në bazë të gjeturave faktike, kemi propozuar tri rekomandime si vijon:

- I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës të hartojë Projektligjin e ri për Mbrojtje nga Diskriminimi.
- I rekomandohet Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që gjatë amendamentimit të Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës, çështjen e diskriminimit ta trajtojë si vepër penale.

- Qeveria e Republikës së Kosovës, në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, të parashohë koston financiare për rekrutimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi, nga ana e komunave dhe në 5 (pesë) ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo pozitë është e pambuluar, në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ajo theksoi se sa i përket rekomandimit të parë, një nismë të tillë mund ta marrim edhe ne si Komision Funkcional, nëse vlerësojmë se do të ishte më mirë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se më dt.12-14 tetor, ka një ftesë nga Komisioni për Legjislacion, për të marrë pjesë në një punëtori për Projektkodin Penal të Kosovës, dhe nëse ju më mbështeteni, unë në atë punëtori mund ta përfaqësojë komisionin dhe të paraqesë edhe rekomandimin e dytë. Sa i përket rekomandimit të parë, tha se është mirë të marrim nismë, si komision, por ndoshta vetëm për plotësim dhe ndryshim, se ndoshta nuk ka nevojë për një projektligj të ri, por vetëm për ndryshim të disa neneve, që grupi punues gjatë monitorimit i ka evidentuar.

Teuta Haxhiu, tha se kur të shqyrtohet Projektligji për buxhetin për vitin 2019, është mirë të propozojmë një amendament, në emër të komisionit për moszbatimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.

Nëse duhet të bëhet nisma për ligj të ri apo ndryshim, duhet të merret një mendim nga IAP dhe të na ndihmojë në këtë drejtim, por për procedimin e këtij raporti sot për në Kuvend, tha se ka dilema. Ajo theksoi se mbështet idenë që Mexhide Mjaku-Topalli, të ngre këtë çështje në punëtorinë, në Komisionin për Legjislacion.

Lirije Kajtazi, tha se disa çështje që u ngritën nga anëtarët e komisionit, janë pasqyruar në raport, te vizitat që i ka pasur grupi punues dhe se disa detyra nga ky ligj janë edhe për Avokatin e Popullit, ndërsa Qeveria, pa dallim, ka dështuar në adresimin e kësaj çështjeje, sidomos tek aspekti gjinor i punësimit.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se nuk kam pasur njohuri që ky ligj nuk zbatohet deri në këtë masë. Po ashtu, theksoi se të gjitha deklaratimet nga të gjitha takimet janë të pasqyruara në raport. Sa i përket komunave, kemi parë nga afër problemet për zbatimin e këtij ligji. P.sh. në Komunën e Prizrenit, zyrtarja për barazi gjinore është e ngarkuar me disa përgjegjësi dhe thotë se nuk po arrin për të treguar sukses në të gjitha fushat e përgjegjësive, me të cilat është e ngarkuar. Situata e njëjtë ishte edhe në Fushë-Kosovë dhe për afërsisht edhe në të gjitha komunat tjera që i kemi vizituar. Pak më mirë ishte Komuna e Podujevës, e cila i kishte zyrtarët e ndarë. Problemi nuk është i tëri te komunat, por edhe te çështjet buxhetore, sepse dihet se në mungesë buxheti nuk mund të shpallen vendet e punës dhe për këtë ne kemi propozuar rekomandimin e tretë.

Sa i përket rekomandimit të parë, ka rezultuar se duhet të bëhet një ligj i ri, pasi që ky nuk zbatohet, por mbetet në kompetencën tonë, se kush ta bëjë këtë. Më tej, theksoi se pajtohet që rekomandimi i dytë të plasohet në Komisionin për Legjislacion nga deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, në punëtorinë e lartpërmendur.

Veton Berisha, tha se është një rregull deri në çfarë mase lejohet të bëhet ndryshimi i ligjit apo të shkohet me ligj të ri, nëse është konstatuar se a e tejkalon atë nivel.

Kryetarja konstatoi se të hënën, më datë 8 tetor 2018, do të organizojmë një takim në orën 10:00, me Avokatin e Popullit, lidhur me rekomandimet për zbatim të këtij ligji.

3. Të ndryshme

Lirije Kajtazi, njoftoi anëtarët e komisionit se grupi punues për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore, sot ka takim në IAP.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit, se ka ardhur një ftesë nga Parlamenti Evropian në Bruksel, për një konferencë më 18 tetor, me temën: Aspektet e të drejtave themelore për përfshirje të romëve dhe luftimi i antiegiptianizmit, ndërsa ne si komision duhet t'i dërgojmë dy deputetë në këtë konferencë.

Më pas, ajo konstatoi se deputetët: Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha, do të marrin pjesë në këtë konferencë, që do të mbahet në Bruksel.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kur ishim në takim me kryetaren e Tetovës, nga biseda ka dalë si mundësi që, në një të ardhme shumë të afërt, të na bëhet një ftesë nga kryetarja e Komunës së Tetovës për një vizitë atje, për të parë praktikën e mira për shërbimet e mira që u jepen fëmijëve, qoftë me aftësi të kufizuara, qoftë atyre me probleme në familje. Është mirë t'i rikujtohet Komunës së Tetovës, sepse është me interes që ne të jemi atje, një apo dy ditë.

Ajo tha se kemi propozuar të vizitojmë zyrat e IAP-it nëpër komuna, shtëpitë e pleqve dhe shtëpitë strehuese të familjeve që kanë marrë fëmijë në strehim.

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit, se ka marrë pjesë në një seminar ndërkombëtar për trafikimin me qenie njerëzore, të mbajtur në Tiranë, nga 25-27 shtator 2018, të organizuar nga Fondacioni për Trafikim me Qenie Njerëzore, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Ajo njoftoi se në fund të këtij seminari është nënshkruar edhe një deklaratë e përbashkët nga të gjithë pjesëmarrësit e shteteve të përfaqësuara në seminar.

Kryetarja konstatoi se anëtarët e komisionit, më dt.8.10.2018, do të bëjnë vizitë në shtëpinë e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara në Deçan dhe Prizren, si dhe të bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit për barazi gjinore, në këto dy komuna.

Në vazhdim, anëtarët e komisionit i dhanë mbështetje të plotë shënimit të javës së të ushqyerit të fëmijës me qumësht gjiri.

Ata diskutuan për këtë çështje dhe mbështesin iniciativën e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, për shënimin e kësaj jave, që ka filluar nga 1 tetori dhe do të zgjasë deri më 7 tetor 2018.

Nënkryetarja, Lirije Kajtazi, ngriti çështjen e shkollave shqipe në veri të vendit, ku nxënësit po mësojnë ende në kontejner. Ajo theksoi se janë pengesa të institucioneve lokale, për mosndarje të pronës për ndërtimin e shkollës. Është mirë që ne, si komision, të interesohemi qoftë me shkresë, qoftë me anë të një vizite, që të shohim për së afërmi këtë gjendje, sepse kjo situatë është e patolerueshme.

Kryetarja, tha se do të ishte më mirë që t'i ftojmë në komision përfaqësuesit e shkollës “Ganimete Tërbeshi”, drejtorin Komunal të Arsimit dhe kryetarin e Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje